

Tiranë, më 02.12.2019

NJOFTIM

“Për shtyrjen e afatit të dorëzimit dhe hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur” me objekt “Blerje Uniforma për personelin e shërbimit të urgjencës mjekësorë”

Në zbatim të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj me objekt “Blerje Uniforma për personelin e shërbimit të urgjencës mjekësorë” me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: 57,900,605 (pesëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind mijë e gjashtëqind e pesë) Lekë pa TVSH, duke qenë se, afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave për këtë procedurë prokurimi është përcaktuar data 09.12.2019 ora 12:00 e cila rezulton të jetë festë zyrtare, hartoi këtë njoftim për shtyrjen e afatit të dorëzimit dhe hapjes së ofertave, si më poshtë:

Në dokumentet e tenderit, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Ishte :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **09/12/2019** (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**

Vendi: ëëë.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **09/12/2019** (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**

Vendi: Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Bëhet :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **10/12/2019** (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**

Vendi: www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **10/12/2019** (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**

Vendi: Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.

